

**V E N D I M**

**Nr. 11, datë 24.11.2020**

**PËR**

**MIRATIMIN E FUNKSIONEVE TË EKSPERTËVE/BASHKËPUNËTORËVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR BOTIMET E QENDRËS SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT**

Bazuar në Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 për “*Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*”, Vendimin nr. 601, datë 04.09.2019, “*Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët*”, si dhe aktet nënligjore në fuqi, me propozimin e drejtorit të QSPA-së,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e detyrave funksionale të ekspertëve/bashkëpunëtorëve me kontratë të përkohshme për botimet e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët të pasqyruar në nenin përkatës “Detyrat e ekspertit” në kontratën tip të shërbimit lidhur ndërmjet drejtorit të QSPA-së dhe ekspertit, bashkëlidhur si Aneks dhe pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Miratimin e detyrave funksionale të përfaqësuesve të strukturës të revistës së Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët “Continuum”, të pasqyruar në nenin përkatës “Detyrat e strukturës” në kontratën tip të shërbimit lidhur ndërmjet drejtorit të QSPA-së dhe ekspertëve/bashkëpunëtorëve me kontratë të përkohshme si Aneks dhe pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Këshillit Koordinues të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët**  
**Prof. Merita Bruçi**

**Anëtarë**

**Z. Pëllumb Xhufi** \_\_\_\_\_

**Znj. Mira Hoxha** \_\_\_\_\_

**Znj. Etleva Domi** \_\_\_\_\_

**Znj. Sonila Hysi** \_\_\_\_\_

**Znj. Flora Koleci** \_\_\_\_\_

**Z. Damiano Guagliardi** \_\_\_\_\_

**Z. Zef Chiamonte** \_\_\_\_\_

QSPA 